

## BASHKËPUNIMI EKONOMIK SHQIPËRI-TURQI



Thellimi i bashkëpunimit ekonomik mes Shqipërisë dhe Turqisë ishte qëllimi kryesor i vizitës që Ministria Anila Denaj zhvilloi në Turqi. Gjatë vizitës, Ministria Denaj nënshkroi Protokollin e Bashkëpunimit të Sesionit të 12-të të Komisionit të Përbashkët Ndër-Queveritar për Bashkëpunim Ekonomik, Tregtar, Industrial dhe Teknik Turqi- Shqipëri, së bashku me kreun e këtij Komisioni, z. Mehmet Muharrem Kasapoğlu, njëherazi, Ministër i Sportit dhe Rinisë. Ministria Denaj vlerësoi ecurinë e bashkëpunimit ekonomik dhe tendencën në rritje të shkëmbimeve tregtare ndërmjet dy vendeve, ndërsa pohoi se ekzistojnë mundësi të mëdha për zgjerimin e tyre dhe kalimin në një fazë më të avancuar dhe me projekte konkrete. Palët dakordësuan bashkëpunimin e tyre në vijim në fusha si tregtia, energjia, industria, arsimi dhe formimi profesional, shëndetësia, turizmi, transporti, bujqësia dhe mjedisi.

## PËRMIRËSIMI I KLIMËS SË BIZNESIT




Qeveria është e angazhuar përmes reformave për përmirësimin e klimës së të bërit biznes dhe tërheqjen e investimeve të huaja. Ky ka qenë mesazhi që Ministria Denaj dha në aktivitetin e Confindustria Albania, me temë: "Investimet e huaja në Shqipëri, prezantimi i Guidës së Biznesit 2020". Ministria përmendi disa nga nismat më të fundit të qeverisë, si dixhitalizimi i shërbimeve publike, Fiskalizimi dhe projektligji i unifikuar i investimeve, të cilat synojnë lehtësimin e biznesit, uljen e informalitetit dhe më shumë siguri për investitorët. Sa i përket marrëdhënieve ekonomike mes Shqipërisë dhe Italisë, Ministria tha se për vitin 2019 Italia është pozicionuar si vendi i parë për fluksin dhe stokun e investimeve të huaja direkte, me 32 % të IHD-ve në Shqipëri, sipas të dhënave të 9 muorit, me një fluks në vlerën e 98 milionë euro.

## DIXHITALIZIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE



Shërbimi Kombëtar i Punësimit ofron 24 shërbime online për qytetarët, që nga data 1 janar 2020. Disa prej këtyre shërbimeve janë aplikimi për regjistrim si punëkërkuar i papunë, deklarimi i vendeve të lira të punës nga biznesi, regjistrimi në kurset e aftësimit profesional si dhe kërkesat për vërtetime nga zyrat e punës. Gjatë një vizite në zyrën rajonale të Punës në Durrës, Ministria Denaj tha se gjatë vitit 2020 MFE do të ofrojë 477 shërbime online, nga 5 institucione të saj të varësisë. Sipas Ministres, një pjesë shumë e rëndësishme është rishikimi i dokumentacionit, ku 149 dokumente që i përkasin 477 shërbimeve online që ofron MFE nuk do të merren më nga qytetarët, por nga punonjësit e administratës. Vetëm për MFE, digjitalizimi i shërbimeve publike do të kursejë apo lehtësojë 70% të kohës dhe 70% të dokumentacionit.

## LUFTA KUNDËR INFORMALITETIT 2020



Lufta kundër informalitetit do të jetë një prej prioritetëve kryesorë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë gjatë këtij viti, ku Administrata Tatimore ka një rol tepër të rëndësishëm. Gjatë periudhës 2-22 janar 2020, Administrata Tatimore ka kryer 1,318 kontrolle, ndërsa janë konstatuar 665 shkelje të legjislatcionit tatimor. Ndër këto shkelje, 39 subjekte janë konstatuar të paregjistruara; 174 tatimpagues janë penalizuar për shkeljen e moslëshimit të kuponit tatimor; 71 janë penalizuar pasi janë konstatuar me punonjës të padeklaruar; 17 nuk kanë pasur të instaluar pajisjen fiskale dhe 25 tjerë nuk i mbanin pajisjet fiskale në gjendje pune. Administrata Tatimore fton dhe nxit të gjithë tatimpaguesit të vetëdeklarojnë në mënyrë korrekte e në respektim të ligjit, duke ju siguruar se monitorimi do të përfshijë çdo subjekt, që prish konkurrencën e ndershme në treg.

## INFORMIMI I BIZNESEVE



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve zhvilloi një takim me biznese të qarkut të Gjirokastrës, me qëllim informimin e bizneseve mbi përkrahjen që AIDA ofron për to, mundësitë për ndërlidhjen e kompanive nëpërmjet platformës B2B, etj, skemat e granteve që mundësohen për sipërmarrjet shqiptare nëpërmjet AIDA-s, etj. Përfaqësues nga bizneset pjesëmarrëse ngritën çështje dhe problematika konkrete të hasura në punën e tyre të përditshme, veçanërisht në sektorin e artizanatit dhe turizmit. Diskutimet mes palëve u përqendruan edhe mbi promovimin e produkteve "Made in Albania", zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja në mbështetje të biznesit shqiptar. Pjesëmarrësve iu prezantua Rrjeti European i Ndërmarrjeve dhe shërbimet që ai ofron me synim rritje e aftësisë konkurruese dhe inovative të tyre në tregun european e më gjerë.

## PUNËSIMI PËRMES ZYRAVE TË PUNËS



1014 persona janë punësuar në gjithë vendin nëpërmjet ndërmjetësimit të zyrave të Punës gjatë periudhës 17-23 Janar 2020. Numrin më të madh të të punësuarve e ka qarku i Tiranës me 346 persona, i ndjekur nga qarku i Fierit me 280 persona, qarku i Durrësit me 116 persona, etj.